

## Punëtorët e pastrimit në Deçan i gjejnë dy granata dore – Ndërhyn njësia për deminim



02/09/2025 09:26

f

tw

link

Gjatë orëve të mëngjesit të sotëm, punëtorët e pastrimit të qytetit në Deçan kanë hasur në dy mjete të dyshuara shpërthyesë, përkatësisht granata dore, teksa po grumbullonin mbeturinat.

Sipas informacioneve zyrtare, menjëherë pas raportimit të rastit, në vendin e ngjarjes ka dalë njësia për deminim e Policisë së Kosovës, e cila ka bërë tërheqjen dhe neutralizimin e sigurt të granatave., raporton [lajmi.net](#)

Fatmirësisht, nuk raportohet për persona të lënduar dhe situata është vendosur nën kontroll brenda një kohe të shkurtër. Autoritetet kanë bërë të ditur se rasti është duke u hetuar për të zbuluar origjinën dhe rrethanat e pranisë së mjeteve shpërthyesë në atë zonë.

Policia ka apeluar për vigjilencë dhe ka kërkuar nga qytetarët që në raste të ngjashme të shmangin kontaktin me mjete të dyshimta dhe të lajmërojnë menjëherë organet kompetente./[Lajmi.net](#)/

### LAJME TË FUNDIT

Operacioni i kërkim-shpëtimit në Bjeshkët e Nemuna në...

Sindikatat: Pagat nuk përputhen me koston e jetesës

Hoti: Kuvendi nuk është i konstituuar, janë shkelur parimet kushtetuese

Hargreaves jep detaje për takimin me Osmanin, flet...

### Artikuj të ngjashëm



September 2, 2025

Operacioni i kërkim-shpëtimit në Bjeshkët e Nemuna në Deçan përfundon me...



September 2, 2025

Sindikatat: Pagat nuk përputhen me koston e jetesës



info@lajmi.net  
Tel: +383 49 131 131  
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrrja nr.

RRJETET SOCIALE



### Other Links

[Fact-Checking Policy](#)  
[Ethics Policy](#)  
[Corrections Policy](#)  
[Ownership & Funding Information](#)  
[Editorial Team Information](#)